



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 04.09.2012, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi-OSBE; Nevahir Hazeri-KDI; Visar Bivolaku-Eu OFFICE-EUSR; Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri dhe Florije Kryeziu-UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 29 qershor, 10 dhe 11 korrik 2012;
3. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve;
4. Shqyrtimi i kërkesës së KPU-së për inspektimin e cilësisë dhe të sasisë së mallrave;

5. Marrja e qëndrimit lidhur me peticionin e Këshillit organizativ të fshatit Orllan - Podujevë;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 29 qershor, 10 dhe 11 korrik 2012.

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 29 qershor, 10 dhe 11 korrik 2012.

3. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve

Kryetarja- I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me disa kërkesa të qytetarëve dhe ftoi grupin e punës që të njoftojë Komisionin.

Mirëpo, Komisioni mori qëndrim që grupi i punës të zgjerohet edhe me një anëtar dhe me propozimin e Suzana Novoberdaliut- kryetare, komisioni zgjodhi në mënyrë unanime deputeten Albana Gashi, e cila do të ketë mandat në shqyrtimin e kërkesave dhe peticioneve, bashkë me dy anëtarët tjerë.

Biserka Kostiq- Bëri vërejtje lidhur me materialet, të cilat u shpërndahen anëtarëve të Komisionit, e që nuk i ofrohen me kohë dhe nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe.

Pas një diskutimi në mes kryetares së Komisionit dhe deputetes në fjalë, u kërkuar nga administrata, që lidhur me këtë çështje të kenë kujdes sa i përket përkthimeve të materialeve dhe shpërndarjes me kohë.

Suzan Novoberdaliu- Kërkoi nga grupi i punës që të marrin fjalën rreth shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve.

Rita Hajzeraj- Tha se grupi i punës e ka shqyrtuar kërkesën e Handikos-it të Drenasit, i cili kërkon nga menaxhmenti i Newko Feronikel Kompleks.L-C-Drenas, që ta kthejë në punë Avni Hasanin, i cili ka punuar si udhëheqës i ndërrimit të zjarrfikësve për pesë vite, deri më 30.06.2012. Ajo tha se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me ç' rast i njëjti ka pësuar lëndim në vendin e punës dhe ka dëmtuar boshtin kurrizor. Sipas analizave të mjekëve, lëndimet nuk kane qenë shumë të mëdha dhe i njëjti punëtor ka kërkuar që të kthehet në punë më të lehtë dhe më të përshtatshme në atë kompani, duke i respektuar dispozitat e ligjit për aftësim dhe riaftësim, si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Por kjo deri më tani nuk ka gjetur mbështetje nga ana e kompanisë e as nga ana e institucioneve të vendit. Ajo theksoi se pas shqyrtimit të lëndës, kërkoi nga Komisioni që të nxjerrë rekomandim, me të cilin do t'i rekomandojë kompanisë Newko

Feronikel Kompleks.L-C-Drenas, që të miratojë kërkesën e Handikos-it dhe t'i respektojë ligjet që janë në fuqi, duke i ofruar mbështetje dhe përkrahje punëtorit në fjalë.

Albana Gashi- Duke u ndërlidhur me kërkesën e Handikos-it, tha se kompania e ka për detyrë të respektojë të tri ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve, si dhe të kryejë obligimet ndaj këtij personi, ndërsa është e drejtë e punëtorit se a pranon punën që i caktohet apo jo.

Komisioni, pas një debati të gjerë lidhur me kërkesën e Handikos-it, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Kompanisë Newko Feronikel Kompleks.L-C-Drenas, në të cilën personi është lënduar, që t'ia përshtatë një vend të punës punëtorit Avni Hasanit, në bazë të shkallës së lëndimit.

Rita Hajzeraj- I njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën e qytetarit, A.H nga Medveci, KK- Lipjan, i cili thekson se ka kushte të vështira ekonomike dhe u kërkon institucioneve komunale që t'i dalin në ndihmë, por deri më tani kjo kërkesë e tij nuk ka gjetur mbështetje nga ana e Komunës së Lipjanit.

Kryetarja- Kërkoi nga Komisioni që kërkesa t'i drejtohet Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe të vlerësojë se a ka nevojë që këtij personi t'i ndërtohet shtëpia.

Kurtan Kajtazi- Lidhur me peticionin e komunitetit të Obiliqit, që ka të bëjë rreth shpronësimit të tokave, për shkak të ndotjes së ambientit dhe që ka të bëjë edhe me disa kërkesa të tjera të komunitetit.

Komisioni konsideron se disa prej tyre janë të arsyeshme dhe duhet të realizohen, ndërsa disa kërkesa bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Lidhur me këtë, të kërkohet se çfarë po ndodh me komunitetin e atyre fshatrave lidhur me procesin e zhvendosjes së banorëve të Hades, si dhe kërkesat për pagimin e shpronësimeve të tokave.

Ai i përmendi kërkesat e shtruara në peticionin e banorëve të fshatrave Dardhishtë, Mirash dhe Bardh, si dhe të shqyrtohen nga ministritë përkatëse, si: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Shëndetësisë etj. Në fund, lidhur me kërkesën për lirim e energjisë, ishte i mendimit se kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet ngase tarifat e energjisë elektrike janë të barabarta për të gjithë qytetarët, pa dallim. Sa i përket kërkesës së tyre, për të pasur rrymë 24 orë, në këtë çështje nuk mund të ndërhyjmë, sepse nuk bie në fushëveprimtarinë e këtij Komisioni.

Rita Hajzeraj- Lidhur me kërkesën e XH. Z. i kërkoi Komisionit që t'i jepet mundësia këtij qytetari të dëgjohet lidhur me shqetësimet dhe pozitën e vështirë sociale e materiale që ai ballafaqohet.

Komisioni vendosi që kjo kërkesë në këtë mbledhje të mos shqyrtohet, por në mbledhjen e ardhshme të jetë prezent vet Xh. Z. i cili në vija të trasha do ta informojë Komisionin.

4. Shqyrtimi i kërkesës së KPU për inspektimin e cilësisë dhe të sasisë së mallrave

Rita Hajzeraj- Në cilësi të raportuesit të shqyrtimit të kërkesës së kompanisë KPU-Inspekt, që të bëjë me inspektimin e cilësisë dhe sasisë së mallrave, e njoftoi Komisionin shkurtimisht rreth gjendjes së krijuar të punëtorëve të kësaj kompanie, në raport me MTI-në, e cila e ka mënjeluar nga procesi i vlerësimit të cilësisë së naftës, duke marrë kompaninë nga Zagrebi, e cila konsiderohet se nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Ajo tha se kishte kontaktuar personat adekuat dhe ka marrë përgjigje se nuk ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, por bëhet fjalë për cenim të interesave të kompanive të ndryshme.

Kryetarja- Lidhur me këtë petition, ftoi anëtarët e Komisionit për debat

Kymete Bajraktari - Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës, theksoi se nëse ka shkelje të të drejtave të njeriut, përveç Komisionit për Zhvillim Ekonomik, objekt i shqyrtimit të tij duhet të ishte edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut.

Kurtan Kajtazi- Lidhur me këtë çështje tha se gjatë shqyrtimit të kësaj lënde kemi kontaktuar persona adekuat që janë njohës të mirë të kontrollit të naftës dhe njohës të udhëzimeve administrative dhe kemi arritur deri te përfundimi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit tonë, por si komision duhet t'ia adresojmë Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

Kryetarja – Në këtë drejtim, kryetarja, por edhe deputetja Albana Gashi ishin të pajtimit se ky njoftim duhet t'ia adresohet Komisionit për Zhvillim Ekonomik.

Ajo tha se edhe unë konsideroj se duhet adresuar te Komisioni për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Komisioni, pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me njoftimin e proceduar nga kompania KPU Inspekt, nxori këtë

Përfundim

Komisioni konstatoi se njoftimi i KPU Inspekt sh.p.k. , për inspektimin e cilësisë dhe sasisë së mallrave, nuk bie në kompetencën e tij. Prandaj, vendosi që njoftimin, bashkë me shkresat lëndore, t'ia procedojë Komisionit për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

5. Marrja e qëndrimit lidhur me petitionin e Këshillit organizativ të fshatit Orllan-Podujevë

Rita Hajzeraj –Në cilësinë e raportueses, ajo kërkoi nga Komisioni që të merret një qëndrim lidhur me petitionin e Këshillit organizativ të banorëve të Orllanit, Komuna e

Podujevës, meqë lidhur me këtë, Komisioni ka dëgjuar Këshillin organizativ dhe kryetarin e Komunës së Podujevës.

Albana Gashi- Ishte e mendimit që Kuvendit të Komunës së Podujevës, t'i rekomandohet për ndarjen e mjeteve nga fondi i Komunës dhe të përshpejtohet procedura e hartimit të projektit, ngase sipas saj, pa projekt nuk mund të thithen donacionet nga donatorët dhe njëkohësisht këtij projekti t'i ndihmohet me mjete shtesë nga ana e ministrisë dhe Qeverisë së Kosovës.

Me propozimin e deputetes u pajtuan të gjithë anëtarët e Komisionit. Lidhur me këtë, Komisioni nxori këtë

REKOMANDIM

1. Komisioni i rekomandon kryetarit të Komunës së Podujevës, që sa më parë të përshpejtojë procedurën e hartimit të projektit të ujësjellësit për këtë rajon dhe të ndajë mjetet buxhetore për financimin e tij.
2. Komisioni kërkon nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të participojë mjete financiare dhe të ndihmojë komunën në realizimin e këtij projekti për furnizim me ujë për banorët e lartpërmendur, sepse furnizimi me ujë i atyre banorëve është i një rëndësie të veçantë.

Kurtan Kajtazi – Në cilësi të raportuesit, njoftoi Komisionin për kërkesën e Avokatit të Popullit, i cili ka kërkuar zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe kthimin e Xhelal Musës në punë nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Shtimes.

Ai tha se Avokati i Popullit ka kërkuar me shkrim për kthimin e tij në punë, por deri më tani nuk ka treguar vullnet të mirë.

Komisioni, pasi e dëgjoi raportuesin, lidhur me këtë çështje nxori këtë

Përfundim

Komisioni i rekomandon Komunës së Shtimes që të zbatojë vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe të kthejë në punë ankuesin, sipas udhëzimeve të ofruara.

Komisioni vendosi që kërkesën e A. dhe F. M nga Gjakova, ta shqyrtojë në mbledhjen e radhës dhe t'i dëgjojë lidhur me problemet që kjo familje po ballafaqohet.

2. Të ndryshme

Në të ndryshme, **Albana Gashi** ngriti dy çështje, lidhur me grevën e të burgosurve në burgun e Dubravës, e cila ka filluar dhe kërkoi që pas mbledhjes të vizitohet ky Institucion nga disa anëtarë të Komisionit.

Kryetarja- U pajtua me propozimin e parafolësës lidhur me vizitën e menjëhershme që do t'i bëhet këtij Institucioni ndëshkimor, por ajo tha se nuk do të marrë pjesë, pasi që ka angazhime të tjera.

Komisioni, lidhur me këtë çështje, pra rreth vizitës në burgun e Dubravës, nxori këtë
Përfundim

Komisioni caktoi deputetet: Alabana Gashi, Rita Hajzeraj, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari, që të vizitojnë burgun e Dubravës dhe për së afërmi të njihen me kërkesat dhe problemet me të cilat ballafaqohen të burgosurit grevistë.

Albana Gashi- Njoftoi Komisionin lidhur me artikullin e publikuar në gazetën “Koha ditore” në të cilin artikull është sulmuar komisioni, kinse nuk ka marrë pjesë në tubimin që është organizuar dhe mbajtur për Ditën Ndërkombëtare të të Pagjeturve. Ne atë artikull, kryetari i shoqatës së të pagjeturve të Komunës së Podujevës, e ka sulmuar kryetaren e këtij Komisioni, kinse nuk ka gjetur kohë për të dalë dhe për t'u solidarizuar me familjarët, si dhe shoqatat e të pagjeturve, dhe Komisionin qeveritar rreth vendosjes së gurthemelit të memorialit. Ai ceku se mosinteresimi i deputetëve dhe vetë kryetares për të marrë pjesë.

Me propozimin e kryetares së Komisionit, anëtarët e Komisionit u pajtuan që të demantohet deklarata e kryetarit të shoqatës së të pagjeturve të Podujevës, sepse kryetarja ishte e pranishme në tubimin e organizuar, ku fjalën e rastit e paraqiti Kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, bashkë me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa. Ajo tha se Komisionit qeveritar dhe të gjitha shoqatave u kam dërguar një telegram përshëndetës dhe jemi solidarizuar me ta dhe kam nënshkruar në emër të Komisionit parlamentar.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali